



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.72/2020**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP** i përbërë nga anëtarët: Rustem Thaçi kryesues, Adnan Konushevci dhe Burim Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit e Lartë Ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik “Partia Socialdemokrate” (PSD), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me Nr.935-2020 të datës 21.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos ndryshimit të llogos-shenjës të subjektit politik “Partia Socialdemokrate” (PSD), në regjistrin e partive politike, në seancën e panelit të mbajtur me 26.10.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i subjektit politik “Partia Socialdemokrate” (PSD), i paraqitur kundër vendimit Nr.935-2020 të datës 21.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

## **Arsyetim**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, me datë 21.10.2020 ka pranuar një apel nga subjekti politik PSD, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokolli Nr.935-2020 të datës 21.10.2020, me të cilën thekson se KQZ me datën 21.10.2020, ka marrë vendimin me nr. 935-2020, për mos ndryshimin e llogos-shenjës së subjektit politik PSD, për shkak të gabimit teknik, gjatë aplikimit duke dërguar statutin e partisë në versionin e vjetër, në vend të aplikimit me version të ri të statutit të partisë. Parashtruesi i apelit thekson se për ndryshimin e llogos-shenjës së partisë kanë ndjekur procedurat e përcaktuara me statut dhe se janë mbajtur mbledhjet e nevojshme ku është bërë votimi për ndryshim të njëjtës.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ-ZRPPC, me nr. Protokolli 72-3/2020 të datës 23.10.2020, theksohet se me datën 21.10.2020 me rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike KQZ-ja, ka refuzuar kërkesën e subjektit politik PSD,

për ndryshimin e llogos-shenjës së të njëjtës parti, për shkak të mos përshtatshmërisë së legjislacionit në fuqi me statutin e subjektit politik PSD. Sipas nenit 32 të Statutit, Kuvendi i partisë politike është organi kompetent për të aprovuar ndryshimet e Statutit, me shumicën përtej gjysmës së votave, të numrit të përgjithshëm të anëtareve të Kuvendit dhe jo të Këshillit Drejtues, i cili në këtë rast ka aprovuar ndryshimin e llogos-shenjës.

Me 22 korrik 2020 PSD, ka dërguar statutin e partisë i cili përmban përshkrimin e logos së vjetër, si dhe procedurat për ndryshimin e statutit dhe sipas kësaj vetëm kuvendi i partisë mund të ndryshoj statusin.

Me datë 31 gusht ZRPPC, i ka komunikuar PSD-së, të gjeturat dhe mungesat në dokumentacionin e dorëzuar ku thuhet që statuti i PSD-së, saktësisht neni 7 përshkruan në detaje logon e partisë, që do të thotë se për të ndryshuar të njëjtët duhet ndryshuar edhe statuti, pastaj logon që ka dorëzuar PSD, në ZRPPC, përmban edhe një slogan që e bën më kompleks procesin e aprovimit nga ana e KQZ-së. Po ashtu sa i përket çështjeve teknike të takimit të Këshillit Drejtues, PSD nuk ka dorëzuar listën me nënshkrimet e pjesëmarrësve në takim, listë e cila është e domosdoshme për tu dorëzuar.

Pavarësisht nga përgjigja e PSD-së, që ka bërë gjatë komunikimit me ZRPPC-në, se ndryshimi i logos, ka ndryshuar automatikisht edhe statutin e PSD-së, në versionin final të dërguar nga PSD-ja qëndron versioni i vjetër i logos.

Kështu që bazuar në këtë KQZ-ja, në mbledhjen me numër 41 të mbajtur më datë 21 tetor 2020 ka aprovuar rekomandimin e ZRPPC për refuzimin e kërkesës së PSD-së.

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Vendimin e KQZ-së për refuzim
- Komunikimet Elektronike që ka bërë me PSD-në.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve nga apeli, vendimit kontestues të datës 21.10.2020 me numër protokolli Nr.935-2020 të KQZ-së, dhe përgjigjes në apel, të KQZ-ZRPPC-së erdhi në përfundim se:

#### **Apeli është i pabazuar.**

PZAP, konstaton se KQZ-ja, me vendimin me Nr.935-2020 të datës 21.10.2020, ka vendosur drejt kur ka bërë refuzimin e kërkesës së subjektit politik Partia Socialdemokrate-PSD për ndryshimin e llogos-shenjës të po të njëjtit subjekt.

Dispozita e nenit 10.2 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka përcaktuar që *"Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të paraparë në nenet 10.1 a) deri në d) të kësaj rregulle, dorëzon kopjen e procesverbalit të mbledhjes ose procedurës me të cilin është miratuar ndryshimi, e cila duhet të jetë e vërtetuar nga kryetari i partisë"*

Paneli, vlerëson se nga shkresat lëndës, subjekti politik PSD, nuk i ka ndjekur procedurat e parapara ligjore dhe se të njëjtat nuk i ka harmonizuar me statutin e subjektit të tyre politik, të cilat përcaktohen me nenin 7 të Statutit të Partisë.

Me nenin 32 të Statutit të subjektit politik PSD, përcaktohet se: *“Kuvendi i PSD-së, Aprovon Programin dhe Statutin e Partisë, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre”*, në këtë rast subjekti politik PSD, ndryshimet i ka bërë Këshilli Drejtues, i këtij subjekt politik. Përveç kësaj subjekti politik PSD, nuk ka vepruar në kuptim të udhëzimeve të dhëna nga ZRPPC-ja.

Andaj duke ju referuar të cekurave më lart paneli, vlerëson se vendimi i KQZ-së, me Nr. 935-2020 të datës 21.10.2020, për refuzimin e kërkesës për mos ndryshimin e llogos-shenjës së subjektit politik PSD, është i drejtë dhe i ligjshëm duke u mbështetur në nenin 10.1 Rregullës Zgjedhore 01/2013, për arsye se subjekti politik, në fjalë nuk ka vepruar, komfor nenit 7 lidhur me nenin 32, të Statutit të Partisë.

Paneli, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi i ka vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera të theksuar në apel mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka erdhi në përfundim se apeli është në tërësi i pabazuar.

Për arsyet e cekura si më lartë e duke u mbështetur në nenin 115 paragrafi 1 lidhur me nenin 118 paragrafi të 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 72-2020 më datën 26.10.2020



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.*